

FTESË PËR OFERTË

Lënda: *Kërkohet ofertë për pjesëmarrje në procedurën e tenderit të hapur “Kërkesë për ofertë” me objekt “Kompani auditimi financiar” për organizatën jo-qeveritare “Qëndresa Qytetare”.*

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj në postën elektronike financa@qq.com.al ose në zarf të mbyllur me vulë me emërtimin: **Kompani auditimi financiar** pranë zyrës të organizatës sonë deri më datë **31/08/2024, ora 17:00. (ky afat do aplikohet në çdo vit pasardhës).**

“Qëndresa Qytetare” është një organizatë jo fitimprurëse që synon të kontribuojë në fuqizimin e rolit të qytetarit në shoqëri nëpërmjet advokimit të politikave, ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes qytetare dhe zhvillimit të kapaciteteve të grupeve komunitare për një qeverisje të mirë.

Adresa e dorëzimit të ofertës: **Qëndresa Qytetare, Rr.Ali Pashë Gucia, Nd.42, H.0, 1026, Tiranë**
– <https://qq.com.al/>

Përshkrimi i shërbimit që kërkohet:

Qëndresa Qytetare, kërkon të kontraktojë një auditues/kompani auditimi me qëllim auditimin e jashtëm të organizatës. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet kombëtare të auditimit sipas SKK për organizatat.

Raportet e Auditimit do të lëshohen në gjuhën Shqiptare dhe Angleze. Raportet e auditimit do të mbulojnë këto periudhë auditimi:

Periudha: [01/01/2023 në 31/12/2023] - raporti i auditit dorëzohet më datë 30 shtator 2024.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

Të gjitha subjektet e interesuara që përmbushin kriteret dhe kushtet janë të ftuara të dorëzojnë propozimin e tyre me zarf të mbyllur e cila do të përmbajë:

1. Certifikatë regjistrimi QKB.
2. Licensë auditimi
3. CV e audituesit ose/dhe kompanisë (ku të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune)
4. Certifikata të ndryshme nëse ka
5. Metodologjia e punës dhe koha e zbatimit sipas Tors- bashkëlidhur
6. Vendndodhja e subjektet: Shqipëri

Oferta do të dorëzohet me “zarf/email”.

Në zarf/email do të vendosni të gjithë dokumentacionin e listuar si më poshtë:

1. Ekstraktit mbi historikun e subjektet të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKB).
2. Propozimi financiar i ofertuesit do të jetë në Euro, do të përfshijë çmimet për shërbimin e listuar.
3. Në çmimet e mësipërme do të përfshihen të gjitha kostot e tjera që lidhen me ofrimin e shërbimeve.
4. Çmimi për njësi në propozimin financiar do të specifikojë që TVSH-ja është e përfshirë.
5. Çmimet e propozuara do të jenë të vlefshme për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës.
6. Kodi i Sjelljes së Subjekteve të Qëndreses Qytetare (të firmosur dhe të vulosur).

PROPOZIMI FINANCIAR:

Zarfi/ email do të ketë mbishkrimin/subjektin “Ofertë për shërbim auditim financiar”.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Për çdo pyetje ose sqarim, apo informacion shtesë mund të na kontaktoni nëpërmjet e-mail: financa@qq.com.al .

Çdo përgjigje e pyetjeve që do bëhet nga subjektet që marrin pjesë në tender, do të njoftohet nga email zyrtar brenda afateve të parashikuara.

Vlerësimi ofertave zhvillohet sipas pikëzimit me poshtë:

- CV e audituesit ose/dhe eksperiencia e kompanise - 30 %
- Metodologjia e punës dhe koha e zbatimit - 35%
- Propozimi financiar - 35%

KUSHTET E KONTRATËS

1. Afati i kontratës: Nga data e nënshkrimit të kontratës deri në 30 Shtator 2024.
2. Nëse nuk plotësohen të gjitha kriteret, subjekti nuk kualifikohet dhe do të vazhdohet me subjektin tjetër të renditur.
3. Pagesa 100% do të kryhet pas pranimi të faturës tatimore për shërbimin e kërkuar sipas planit që do paracaktohet me ofertuesin, nëpërmjet transfertës bankare në numrin e llogarisë të subjektet ofrues.
4. Në ofertën e tij, ofertuesi do të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.
5. Subjekti do të garantojë produkte cilësore.